



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik BERISHA COM SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik BERISHA COM SH.P.K e dt. 11.12.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 08.12.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 08.12.2020;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik BERISHA COM SH.P.K, me datë 11.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- 1. Për pretendimin tuaj të parë:** ne LPP dhe RRUOPP nuk shkruan qe cili prej anëtareve te grupit duhet te paraqitet ne dosjen e tenderit kështu qe kjo pike është e paqëndrueshme;
- 2. Për pretendimin tuaj të dytë:** deklarata edhe pse nuk përmbajnë titullin dhe nr. e prokurimit, deklaratat për te gjithë anëtarët e grupit janë plotësuar siç duhet andaj kjo konsiderohet një shkelje e vogël qe nuk ndikon ne rezultatin përfundimtar te projektit;
- 3. Pretendimi juaj i tretë:** se selia e OE COMPANY BEJTA COMERCE, në deklaratën për betim dhe në deklaratën e konzorciumit janë ndryshe është i qëndrueshëm, mirëpo sipas ARBK selia e OE është ne Gjilan andaj mund te konsiderohet si shkelje e vogël qe nuk ndikon ne rezultatin përfundimtar te projektit pasi qe ne vule është ne rregull;
- 4. Për pretendimin tuaj të katërt:** Deklaratat tatimore i ka ofruar anëtari i konzorciumit gjegjësisht lideri i grupit BEJTA COMMERCE ne vlere prej mbi 2 mil euro e qe e tejkalon vlerën e kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate.
- 5. Për pretendimin tuaj të pestë:** licenca – nuk ka qene fare kërkesë e përzgjedhjes tek kërkesat e kapacitetit teknik e profesional andaj ky pretendim është i paqëndrueshme;
- 6. Për pretendimin tuaj të gjashtë:** kontrata punëtoreve – janë kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për dhënie dhe OE ka ofruar dëshmitë e kërkuara andaj kjo pike është e paqëndrueshëm;
- 7. Për pretendimin tuaj të shtatë:** OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar gjithsej 5 lug ngarkuese, rimorkio me targa 06-408-XB ka peshe 10 ton dhe jo siç është dhëne prej jush, ndërsa rimorkio me targa 06-165-AX dhe 06-178-XB janë ofruar rimorkio shtese andaj nuk janë marr për bazë meqenëse ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate është kërkuar vetëm 1 rimorkio

Tenderi juaj është eliminuar se ka pasur çmim më të lartë dhe për arsye se:

1. Sipas kontratës inxhinieri Xhavit Jasiqi , është pjese e personelit te Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund te kërkohet informacion shtese për kontrate e për te cilën ju thoni se është gabim teknik pasi qe nëse do ndryshohej atëherë i bie qe është falsifikim. Po ashtu, i njëjti inxhinier ka dërguar e-mail me datë 07.08.2020 ku deklaroi se “i punësuar me kontrate te rregullt ne Komunën e Junikut. Se me përgjegjësi morale dhe penale DEKLAROJ se nuk kam asnjë marrëveshje me kompaninë ne fjale për projektin “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me nr. prok. 632-20-1610-521. Po ashtu deklaroj se ndonjë kontrate eventuale për këtë projekt nuk është e nënshkruar nga unë.”;
2. Sa i përket pajisjes Autovinç – është ofruar peshe 14570kg e qe është nen peshën e kërkuar prej “mbi 15t”

3. Sa i përket pajisjes buldozher – është ofruar marrëveshja mirëpo ne te nuk është dhënë pesha, pas kërimit ne internet është pare qe pajisja ka peshe siç është kërkuar mirëpo nuk është kërkuar sqarim shtese pasi qe jeni eliminuar edhe për dy pika tjera ankimore

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës